

VENDIM
Nr. 519, datë 20.9.2017

PËR PËRCAKTIMIN E PËRBËRJES SË KËSHILLIT KOMBËTAR TË TERRITORIT
(botuar në Fletoren Zyrtare Nr.171, 26 shtator)

I azhurnuar me:

- ***VKM Nr.738, datë 13.12.2017 (botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 225, 22 dhjetor 2017)***

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “a”, të pikës 6, të nenit 6, të ligjit nr. 107/2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Këshilli Kombëtar i Territorit, si autoritet kombëtar i planifikimit dhe zhvillimit të territorit, kryesohet nga Kryeministri dhe ka në përbërje:

- | | |
|----------------------------------------------------------------------------|----------------------|
| - Ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë | anëtar; |
| - Ministrin e Financave dhe Ekonomisë | anëtar; |
| - Ministrin e Drejtësisë | anëtar; |
| - Ministrin e Kulturës | anëtar; |
| - Ministrin e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural | anëtar; |
| - Ministrin e Turizmit dhe Mjedisit | anëtar; |
| - Ministrin e Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes | anëtar; |
| - Drejtorin e Përgjithshëm të Agjencisë së Zhvillimit të Territorit | anëtar dhe sekretar. |

2. Kur, për shkaqe të arsyeshme, Kryeministri apo ministri anëtar nuk mund të marrë pjesë në mbledhje, atëherë në vend të tij merr pjesë, përkatësisht, me të drejtë vote:

- **personi i autorizuar nga Kryeministri, i cili kryeson mbledhjen;**
- **zëvendësministri, përfaqësues i ministrit në mungesë.**

3. Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Territorit, për çdo pjesëmarrje në mbledhje, shpërblehen me 20 000 (njëzet mijë) lekë.

4. Shpërblimi i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Territorit të përballohet nga buxhetet e miratuara për çdo institucion përkatës që ata përfaqësojnë.

5. Brenda 20 (njëzet) ditëve kalendarike nga dita e zhvillimit të mbledhjes, Agjencia e Zhvillimit të Territorit (AZHT) zbardh vendimet e Këshillit Kombëtar të Territorit, të cilat ua dërgon për nënshkrim Kryeministrit, në cilësinë e kryetarit të KKT-së, dhe ministrit të linjës për zhvillimin e propozuar.

6. Vendimi nr. 1097, datë 28.12.2015, i Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, shfuqizohet.

7. Ngarkohen të gjitha institucionet, përfaqësuesit e të cilave janë përcaktuar në pikën 1, për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Senida Mesi